

Gratë dhe radikalizimi terrorist Raport përfundimtar

Tryeza e ekspertëve të Sekretariatit të OSBE -ODIHR

Parandalimi i radikalizimit terrorist të grave

Vjenë, 12 Dhjetor 2011

Roli dhe fuqizimi i grave në kundërvënien ndaj
ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon
në terrorizëm

Vjenë, 12 dhe 13 Mars 2012

Ky raport nuk duhet të interpretohet si rekomandim zyrtar i OSBE-së bazuar në një vendim me konsensus, dhe as si qëndrim zyrtar i Sekretariatit të OSBE-së, Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, apo të ndonjë shteti të veçantë pjesëmarrës të OSBE-së; ai pasqyron opinionet e shprehura në mënyrë individuale nga pjesëmarrësit në tryezat e rumbullakëta të ekspertëve.

Ky raport është përkthyer nga gjuha angleze në atë shqipe, arabe, boshnjake, ruse dhe serbe falë mbështetjes financiare të Austrisë.

Vjenë, Shkurt 2013

© OSBE 2013

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret lirisht dhe të kopjohet për qëllime edukative dhe qëllime të tjera jo-komerciale, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një njohje të OSBE-së si burimi i tij.

Njësia e veprimit kundër terrorizmit
Departamenti për Kërcënimet Transnacionale
Sekretariati i OSBE-së
Wallnerstrasse, 6 A-1010 Vienna, Austria
<http://www.osce.org/atu>

Departamenti i të Drejtave të Njeriut
Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
Miodowa 10, 00–251 Warsaw, Poland
<http://www.osce.org/odih>



Përmbajtja

_Toc368656950

Vështrim ekzekutiv	1
Të kuptuarit e radikalizimit terrorist të grave	3
Adoptimi i qasjeve që përputhen me ndjeshmërinë gjinore dhe të drejtat e njeriut	5
Të kuptuarit e rolit të grave në luftën kundër EDHRÇT	7
Angazhimi dhe puna me gratë për të kundërshtuar EDHRÇT	8
Fuqizimi i grave kundër EDHRÇT	9
Rekomandime	11
<i>Rekomandimet për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së</i>	11
<i>Rekomandime për strukturat ekzekutive të OSBE-së</i>	12
<i>Rekomandime për shoqërinë civile</i>	13
Shtojca 1: Mandati dhe zotimet e OSBE-së	14
Shtojca 2: Axhenda e tryezës së rrumbullakët të përbashkët të ekspertëve të sekretariatit OSBE-ODIHR mbi “Parandalimin e radikalizimit terrorist të grave”, 12 Dhjetor 2011, Vjenë	15
Shtojca 3: Axhenda e tryezës së rrumbullakët të përbashkët të ekspertëve të sekretariatit të OSBE-ODIHR mbi “Rolin dhe fuqizimin e grave në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit të grave që çon në terrorizëm”, 12-13 Mars 2012, Vjenë	17

Vështrim ekzekutiv

Njësia e veprimit kundër terrorizmit në Departamentin për Kërcënimet transnacionale (TNTD/ATU) dhe Seksioni i barazisë gjinore në Sekretariatit të OSBE-së, së bashku me Zyrën e OSBE për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR), kanë organizuar dy tryeza të rrumbullakëta mbi gratë dhe radikalizimin terrorist, të mbajtura në Vjenë, përkatësisht më 12 dhjetor 2011 dhe 12-13 mars 2012.

Qëllimi i takimeve ishte rritja e të kuptuarit të radikalizimit dhe terrorizmit të grave dhe rolet e grave në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm (EDHRÇT). Ato përfunduan me formulimin e rekomandimeve për veprimet që duhet të ndërmerren nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe shoqërisë civile si dhe sugjerimet për ndjekjen e aktiviteteve të mundshme nga strukturat ekzekutive të OSBE-së, në kuadër të mandatit të tyre përkatës.

Tryeza e parë e rrumbullakët diskutoi dinamikën që qëndrojnë pas radikalizimit terrorist të grave dhe mënyrat për ta parandaluar atë në një mënyrë të ndjeshme gjinore dhe në përputhje me të drejtat e njeriut. Takimi i dytë u fokusua në praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra nga nismat e grave për të parandaluar EDHRÇT, duke e vënë theksin në të drejtat e njeriut dhe preokupimet gjinore që mund të lindin në këtë kontekst.

Të dyja tryezat mbledhën së bashku mbi 190 pjesëmarrëse nga shoqëria civile, bota akademike, organet shtetërore dhe organizatat ndërqeveritare, me ekspertizë në fushën e sigurisë, barazisë gjinore dhe të të drejtave të njeriut.

Ky raport paraqet përfundimet kryesore dhe rekomandimet e dala nga këto takime.

Sfondi

Kërcënimi i EDHRÇT është një shqetësim serioz i vendeve pjesëmarrëse në OSBE. Si autoritetet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare e kanë pranuar gjithnjë e më shumë se një i kuptuar më i mirë i dinamikës së EDHRÇT është thelbësor në formulimin dhe implementimin e strategjive efektive për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

Megjithatë, kur eksplorojnë konceptin e EDHRÇT, shtetet pjesëmarrëse duhet të mbeten të vetëdijshme se 'radikalizimi' dhe 'ekstremizmi' nuk duhet të jenë objekt i masave represive anti-terrorizëm, nëse ato nuk shoqërohen me dhunë apo akte të tjetra të paligjshme, siç përcaktohet ligjërisht në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut (p.sh., grupet ekstremiste të cilat nuk i takojnë, nxisin ose lejojnë veprimtari kriminale dhe/ose dhunë). Mbajtja e pikëpamjeve apo besimeve që konsiderohen radikale apo ekstreme, si dhe shprehja paqësore e tyre, nuk duhen konsideruar si krime *në vetvete*.

Proceset radikalizuese ndjekin rrugë të ndryshme dhe jo-lineare dhe kushtet e favorshme për to ndryshojnë nga një individ tek tjetri. Kuptimi i një shkalle të caktuar të radikalizimit kërkon të merren parasysh faktorët e veçantë kontekstualë dhe personalë në lojë, përfshi konsideratat historike, politike, socio-ekonomike dhe psikologjike. Qeveritë, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare duhet të ri-pohojnë dhe të udhëhiqen nga parimi se terrorizmi nuk duhet të lidhet me ndonjë fe, kulturë, racë, apo përkatësi etnike të veçantë. Gjithashtu, qeveritë duhet t'u përgjigjen në mënyrë të ekuilibruar dhe proporcionale kërcënimeve terroriste të frymëzuara nga ideologjitë e ndryshme për të shmangur përqendrimin në mënyrë jo-proporcionale mbigrupe të caktuara.

Derisa EDHRÇT kapërcen kufijtë socio-politikë, kombëtarë, kulturorë, gjeografikë dhe ato moshorë, ai e kapërcen gjithashtu edhe gjininë. Për dekada të tëra, organizatat terroriste kanë synuar gratë për rekrutim. Mundësia për radikalizimin e grave dhe përfshirjen e tyre në grupet ekstremiste të dhunshme ka ekzistuar prej një kohe të gjatë, por vazhdon të jetë ende relativisht i nënvlerësuar, pasi vazhdon të mbizotërojë koncepti i gabuar që ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi kanë të bëjnë ekskluzivisht me burrat. Megjithatë, sulmet e kohëve të fundit të kryera nga gratë, si dhe të dhënat mbi përpjekjet e vazhdueshme të organizatave terroriste për të rekrutuar gratë, përlligjin marrjen seriozisht të kërcënimit të radikalizimit të tyre terrorist si dhe nevojën për të ndërmarrë veprime parandaluese efektive të ndjeshme gjinore dhe nëpërputhje me të drejtat e njeriut.

Për më tepër, gratë mund të kenë një potencial të veçantë në kundërvënien ndaj EDHRÇT. Përfshirja e grave si politikë-bërëse, edukatore, anëtare të komunitetit dhe aktiviste, është thelbësore për të luftuar kushtet e favorshme për terrorizëm dhe për të parandaluar terrorizmin në mënyrë efektive. Gratë mund të reagojnë në mënyrë vendimtare në përpjekjet aktuale të komunitetit ndërkombëtar kundër terrorizmit dhe mund të tregojnë kur politikatat dhe praktikatat parandaluese kanë ndikime anti-produktive në komunitetet e tyre. Është i nevojshëm eliminimi i faktorëve që e pengojnë pjesëmarrjen aktive të grave në luftën kundër terrorizmit për të lehtësuar përfshirjen e organizatave të grave në identifikimin dhe trajtimin e shqetësimeve specifike politike, sociale, ekonomike, kulturore, arsimore që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizim terrorist. Gratë janë nismëtare efektive të iniciativave dhe përhapëse të ligjëratave për t'iu kundërvënë propagandës së dhunshme ekstremiste dhe terroriste dhe mund të mbajnë një peshë të veçantë në publikun e grave.

Në lidhje me këtë, tryezat e rrumbullakëta të ekspertëve patën si synim:

- Të arrinin në një kuptim më të mirë të specifikave dhe dinamikave të përfshira në radikalizimin terrorist në mënyrë që të reflektohet mbi mundësinë dhe mënyrën se si masat ekzistuese kundër EDHRÇT duhen korigjuar ose duhen përshtatur për t'u bërë të ndjeshme, gjinore dhe nëpërputhje me të drejtat e njeriut për të qenë kështu më efikase;
- Të eksplorohej roli potencial i grave në kundërvënien ndaj EDHRÇT, brenda shoqërisë në përgjithësi, në komunitete dhe familje dhe në mënyrë specifike si të fuqizohen gratë aktiviste dhe organizatat joqeveritare për t'i rezistuar atij;
- Të identifikonin fokusin e përshtatshëm dhe modalitetet e veprimtarive të mundshme për ndjekjen e çështjeve të mësipërme nga strukturat ekzekutive të OSBE-së, në kuadër të mandatit të tyre, si dhe sugjeronin rrugën për të ecur përpara drejt formulimit të rekomandimeve konkrete për aktorët e ndryshëm.

Të kuptuarit e radikalizimit terrorist të grave

1. Duke qenë që ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi terrorist konsiderohen ende si çështje të meshkujve, çështja e radikalizimit terrorist të grave karakterizohet nga paragjyqime dhe keqkuptime. Në situatat e konfliktit dhe dhunës, gratë shpesh shihen si pasive, viktime, të pafuqishme, të nënshtruara dhe nëna. Supozimet e tilla përforcojnë stereotipat gjinorë. Si rezultat, gratë nuk konsiderohen të jenë terroriste potenciale, e as nuk perceptohen të jenë aq të rrezikshme sa homologët e tyre meshkuj nëse do të përfshihen në terrorizëm. Megjithatë, një grua nuk duhet të supozohet se është më shumë ose më pak e rrezikshme, as më shumë e prirur për paqe, dialog, për anti-dhunë dhe bashkëpunim se një burrë. Në fakt, imazhi i gruas paqësore është përdorur nga grupet terroriste për t'i rekrutuar gratë dhe për të pretenduar karakterin e pafajshëm dhe jo të dhunshëm të tyre duke nënvizuar përfshirjen e grave në organizatat e tyre.
2. Është thelbësore të rritet ndërgjegjësimi për ekzistencën dhe mundësinë e radikalizimit terrorist të grave, si dhe për propagandën e dhunshme ekstremiste dhe strategjitë e rekrutimit të drejtuara ndaj grave dhe vajzave. Rëndësi të dorës së parë ka sensibilizimi në lidhje me këtë çështje i prindërve, mësuesve, punonjësve socialë, oficerëve të policisë së vijës së frontit, gazetarëve dhe gjyqtarëve. Në këtë frymë, është e rëndësishme që media të heqë dorë nga përhapja e perceptimeve stereotip të roleve dhe sjelljes së grave.
3. Janë të nevojshme kërkime të mëtejshme shkencore mbi EDHRÇT. Sidoqoftë, në trajtimin e këtij boshllëku, hulumtuesit kanë nevojë të hetojnë mirë për hipotezat e mundshme përmbi punë të tyre dhe metodologjitë që përdorin për të mbledhur të dhëna, si dhe të njohin kontekstin(et) kulturor(e) të kërkimit të tyre. Është gjithashtu e nevojshme që ata të ndjekin një perspektivë të ndjeshme gjinore, të reflektojnë mbi burimet e tyre të informacionit dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike se si janë trajtuar dhe diskutuar çështjet e radikalizimit terrorist të grave.
4. Duhet bërë më shumë hulumtime për të kuptuar se cilat kushte të mundshme specifike mund të çojnë në radikalizimin terrorist të grave. Në këtë drejtim mund të ndihmojë identifikimi i modeleve të përbashkëta të përfshirjes së grave. Sidoqoftë, duke qenë që gratë mund të ndjekin rrugë të ndryshme radikalizimi, është e rëndësishme të merren parasysh kontekstet e veçanta historike, sociale, politike dhe personale të secilit rast për t'u siguruar se faktorët bazë janë kuptuar dhe trajtuar në mënyrë të saktë.
5. Shumë kushte të favorshme për terrorizmin ndikojnë në radikalizimin e mundshëm të dhunshëm të burrave dhe grave. Megjithatë është kritike të kuptohet se si këta faktorë mund të përjetohen në mënyra të ndryshme ndryshëm përgjatë linjave gjinore. Diskriminimi me bazë gjinore mund të përkojë me të dhe të ashpërsojë diskriminimin dhe shkeljen e të drejtave në fusha të tjera, si përkatësia racore, etnia apo feja. Për më tepër, kushtet specifike të favorshme për radikalizimin terrorist të grave mund të përfshijnë pabarazinë dhe diskriminimin me bazë gjinore, dhunën ndaj grave, mungesën e mundësive arsimore dhe ekonomike dhe mungesën e mundësive që gratë të ushtrorë të drejtat e tyre civile dhe politike dhe të angazhohen në procesin politik me mjete të ligjshme dhe jo të dhunshme.
6. Shkeljet e të drejtave të njeriut duke përfshirë rastet kur shkaktohen nga masat kundër terrorizmit të tilla si e drejta për të jetuar dhe e integritetit fizik, e drejta për liri dhe siguri, liria e shprehjes, liria e krijimit të shoqatave dhe e drejta e tubimit paqësor, liria e mendimit, ndërgjegjes, fesë apo besimit, e drejta për mbrojtjen e jetës private dhe familjare, mund ta thellojnë tjetërsimin, izolimin dhe përjashtimin, duke i çuar gratë në rrugën drejt radikalizimit të dhunshëm. Këto shkelje shfrytëzohen shpesh nga grupet

terroriste për të krijuar një diskurs të viktimizimit, për të justifikuar aktet e tyre dhe për të rekrutuar anëtarë të rinj, duke përfshirë gratë.

7. Kur shqyrtojnë radikalizimin terrorist të grave, studiuesit dhe mediat tentojnë të kufizohen në rastet e grave kamikaze, duke përjashtuar si lidërsipin, dhe rolet operative/logjistike dhe/ose ideologjike që ato mund të luajnë. Ata shpesh e shpërfillin mënyrën se si grupet terroriste, mjedisi përkatës i tyre, ideologjia dhe motivimet mund të kenë ndryshuar me kalimin e kohës dhe se si kjo ndërhyr dhe e ndikon përfshirjen e grave në secilin grup.
8. Tepër shpesh, kërkimet akademike dhe politika janë të shkëputur nga njëri-tjetri. Qeveritë dhe kërkuesit kanë nevojë të bashkëveprojnë më shumë për të siguruar që politikëbërja të informohet nga kërkimet. Kërkuesit, shoqëria civile dhe burrat dhe gratë e zakonshëm me formime të ndryshme mund të përfshihen, për shembull, përmes veprimtarive këshilluese në shkëmbimin e mendimeve dhe informacioneve me qeveritë mbi radikalizimin terrorist të grave dhe potencialin e grave për t'iu kundërvënë EDHRÇT, dhe në identifikimin e interesave të përbashkëta.
9. Gjithashtu, një kuptim më i mirë dhe reflektimi mbi radikalizimin terrorist do të përfitonin nga ndërveprimi i zgjeruar i agjencive të zbatimit të ligjit dhe zbulimit me autoritetet publike në fusha të tjera, të tilla si shërbimet e arsimit, shërbimet shëndetësore dhe sociale, në nivel kombëtar dhe lokal. Kjo mund të lehtësohet nëpërmjet krijimit të forumeve të bashkëpunimit ndër-agjenci, me synimin për kryqëzimin e ekspertizës, forcimin e shkëmbimit të informacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi të dyja gjinitë dhe sigurinë midis të gjitha palëve të interesuara.

Adoptimi i qasjeve që përputhen me ndjeshmërinë gjinore dhe të drejtat e njeriut

10. Idetë e gabuara se gratë nuk janë të përfshira në ekstremizmin e dhunshëm apo radikalizimin terrorist shpesh kanë farkëtuar strategji të antiterrorizmit, duke e ashpërsuar përjashtimin e grave nga proceset e vendimmarrjes dhe nën-përfaqësimin e tyre të ndjeshëm në radhët e oficerëve të zbatimit të ligjit dhe personelit të sigurisë.
11. Për më tepër, gjinia është një aspekt i rëndësishëm i sigurisë. Duke qenë se burrat dhe gratë i referohen në mënyrë të ndryshme sigurisë, konfliktit, terrorizmit dhe kundër-terrorizmit, gratë sjellin perspektiva plotësuese në diskutim, të cilat nuk duhet të neglizhohen. Gratë janë shpesh viktima si të sulmeve terroriste dhe tëmasave kundër terrorizmit, dhe, si të tilla, ato mund të tregojnë se kur praktikatat parandaluese janë anti-produktive dhe shkaktojnë reagim të ashpër në komunitetet e tyre. Ky lloj informacioni mund të jetë vendimtar për të shmangur krijimin apo kushtet mbështetëse që çojnë në terrorizëm.
12. Megjithatë, barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk duhet të vlerësohen vetëm në masën se sa ndihmojnë në sigurinë kombëtare dhe kundër terrorizmit. Barazia gjinore duhet të promovohet me të drejtën e vet dhe gratë duhet të fuqizohen për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri dhe të mos instrumentalizohen për të "spiunuar" në komunitetet e tyre. Po ashtu, nuk duhet të bëhet pazar me të drejtat e grave për përfitime të sigurisë. Shtetet nuk duhet që, qëllimisht apo nga pakujdesia, të mos ta respektojnë barazinë gjinore kur negociojnë me grupe terroriste. Në të vërtetë, të drejtat e grave janë të drejta të njeriut, siç është konfirmuar më 1995 në Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim dhe shtetet e kanë për detyrë t'i respektojnë, t'i mbrojnë dhe t'i përmbushin ato.
13. Promovimi i të drejtave dhe i rolit të grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe në ndërtimin e paqes është një shembull i mirë i përfshirjes së grave në sektorin e sigurisë. Rezoluta e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara (RKSKB) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë theksoi rëndësinë e rolit të grave, pjesëmarrjen barabartë dhe përfshirjen e plotë në këtë fushë dhe u bëri thirrje shteteve për të rritur përfaqësimin e grave në të gjitha nivelet e procesit të vendimmarrjes për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Si e tillë, rezoluta dhe mësimet praktike të nxjerra nga zbatimi i saj janë njëburim frymëzimi për të luftuar dhe për të ndërmarrë nisma të reja për rolin e grave në përpjekjet kundër terrorizmit.
14. Ndërkohë që nisma të tilla mund të frymëzojnë angazhimin e grave kundër terrorizmit dhe EDHRÇT, është thelbësore të theksohet se konflikti dhe terrorizmi janë dy koncepte të ndryshme ligjore. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara dhe rezolutat e tjera që lidhen me të, u referohen situatave të konflikteve, siç janë përcaktuar ligjërisht në të drejtën humanitare ndërkombëtare, ndërsa "terrorizmi" nuk është përkufizuar në të drejtën ndërkombëtare, por krimet që lidhen me të trajtohen në konventa të shumta.
15. Politikatat dhe praktikatat kundër terrorizmit duhet të konceptohen për të respektuar të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit në të gjitha kohërat në mënyrë që të jenë të suksesshme. Politikatat dhe praktikatat që janë parashikuar ose janë në fuqi duhet të krahasohen me alternativat e mundshme, të monitorohen në zbatimin e tyre dhe të vlerësohen me kujdes. Është vërtetë themelore që ato të jenë testuar për efektivitetin e tyre, ndikimet pozitive dhe negative. Etapat gjinore duhet të përfshihen në monitorimin dhe vlerësimin e këtyre politikave dhe praktikave dhe mund të jenë efikase vetëm nëse përfshijnë gratë në të gjitha fazat e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit.

16. Në mënyrë që të lehtësojë integrimin gjinor në luftën kundër terrorizmit dhe strategjitë kundër radikalizimit, prania e grave në radhët e profesionistëve të kundër-terrorizmit duke përfshirë edhe ushtrinë, duhet të rritet. Këto struktura kanë nevojë t'i forcojnë përpjekjet e tyre për rekrutimin dhe mbajtjen e grave, duke përfshirë në rolet operative, dhe të sigurojnëqëtë hiqen pengesat në promovimin e tyre në karrierë.
17. Së bashku me monitorimin e qeverisë, duhen inkurajuar gjithashtu dhe monitorimi nga shoqëria civile i radikalizimit terrorist të grave, si dhe strategjitë kundër terrorizmit dhe përfshirjes së grave nëpolitikat e luftës kundër terrorizmit dhe kundër radikalizimit.

Të kuptuarit e rolit të grave në luftën kundër EDHRÇT

18. Gratë mund ta luftojnë EDHRÇT në një gamë të gjerë fushash, në kuadrin e nismave të përshtatura për specifikat e çdo konteksti.
19. Rreziku i radikalizimit terrorist duhet të trajtohet si brenda familjes ashtu edhe nga shoqëria, dhe kjo është arsyeja pse burrat dhe gratë, si prindër, duhet të jenë të gatshëm t'u përgjigjen pyetjeve të fëmijëve të tyre mbi identitetin e tyre fetar, politik dhe kulturor. Një aftësi e tillë është e domosdoshme sepse shumica e proceseve të radikalizimit terrorist zhvillohen midis moshave nga 12 deri në 20 vjeç, kur formohen personalitetet dhe vlerat. Në këtë kontekst, paaftësia e të diskutuarit hapur dhe e trajtimit të çështjeve kritike mund të lërë një boshllëk që rrezikon të mbushet me diskurse ekstremiste të dhunshme.
20. Roli i grave në luftën kundër EDHRÇT nuk duhet të kufizohet vetëm në sferën private. Gratë sjellin një perspektivë të re në diskutimet në këtë fushë dhe për këtë arsye duhet të përfshihen në gamën e plotë të veprimtarive që janë në dispozicion të meshkujve, duke përfshirë në jetën e komunitetit, politikë, në agjencitë e zbatimit të ligjit dhe agjencitë e tjera shtetërore.
21. Është thelbësore që personeli i zbatimit të ligjit i përfshirë në masat kundër terrorizmit të tilla si: pika kontrolli, burgje dhe personeli i sigurisë së aeroportit, të përfitojnë nga trajnimet specifike gjinore dhe të përfshijnë gratë. Këto dy kërkesa mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të masave të sigurisë, si dhe të të drejtave të njeriut dhe të shmangin shkeljet e të drejtave të njeriut të cilat mund të nxisin radikalizimin dhe një reagim të ashpërndaj objektivave të sigurisë.
22. Edhe kontributet dinamike të grave në komunitetet e tyre duhet të vlerësohen dhe inkurajohen. Përvoja e policisë ka treguar, për shembull, se angazhimi i grupeve të grave dhe i rrjeteve informale në parandalimin e EDHRÇT mund të kenë një efekt më të thellë dhe më të vërtetë në komunitetet. Gratë mund të luajnë një rol të rëndësishëm jo vetëm si ndërmjetëse, por dhe si autore dhe përhapëse të diskursit sfidues kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit brenda komuniteteve të tyre. Duke u bërë modele nërolin e tyre, ato mund të ndikojnë në mënyrë pozitive në mjedisin e tyre personal dhe shoqëror.

Angazhimi dhe puna me gratë për të kundërshtuar EDHRÇT

23. Në mënyrë që gratë të angazhohen në mënyrë efektive në komunitetet e tyre, qeveritë duhet të përpiqen për të ndërvepruar më mirë me organizatat e vogla të grave në nivelin bazë më shumë se me udhëheqësit e komuniteteve shpesh të vetë shpallur apo vetëm me organizatat e konsoliduara mirë. Lëvizjet në bazë kanë qasje më të mirë ndaj individëve në nevojë. Gjithashtu, udhëheqësit e komunitetit me të cilët angazhohen zakonisht qeveritë, kanë tendencën të jenë meshkuj dhe të japin këshilla mjaft homogjene dhe pajtuese. Jo gjithmonë pikëpamja e tyre përfaqëson komunitetin dhe ata mund t'u japin përparësi marrëdhënieve të mira me policinë për trajtimin e problemeve serioze.
24. Autoritetet publike mund të identifikojnë gratë aktiviste dhe organizatat kyçe, me aftësitë dhe nevojat e tyre, për të arritur në grupe të ndryshme dhe për të diversifikuar ndërveprimin e tyre me komunitetet. Është thelbësore që ato të vlerësojnë në mënyrë kritike se cilat agjenci shtetërore – policia, shërbimet sociale, shërbimet e arsimit – janë të vendosura mirë për t'u angazhuar me gratë në një situatë specifike dhe ato mund të angazhohen me gra të të gjitha shtresave. Transparenca se pse dhe si ato bashkëpunojnë me organizata apo individë të veçantë është gjithashtu çelësi për besueshmërinë e angazhimit të tyre në sytë e komuniteteve më të gjera dhe publikut.
25. Sidoqoftë, është nevoja që pengesat për këtë bashkëpunim të merren parasysh dhe të kapërcehen. Për shembull, ligje disproporcionale kundër financimit të terrorizmit mund të pengojnë financimin e këtyre organizatave të vogla bazë të grave. Përveç kësaj, fondet qeveritare kundër terrorizmit mund të kenë një konotacion negativ, i cili mund t'i shkurarojë organizatat e shoqërisë civile për t'u angazhuar me autoritetet dhe për të aplikuar për grante të etiketuara si të tilla.
26. Shtetet pjesëmarrëse duhet gjithashtu të shmangen nga zbatimi masave diskriminuese kundër terrorizmit si ato që përdorin profilizimet e bazuara në supozime rreth stereotipit, p.sh. të racës, etnisë, fesë dhe / apo gjinisë. Masa të tilla mund të krijojnë pengesa praktike në angazhimin e grave kundër EDHRÇT dhe të minojnë interesin e grave për të dhe gatishmërinë për të kontribuar në parandalimin e terrorizmit.
27. Kur u shtrijnë dorën organizatave të grave, autoritetet shtetërore duhet të identifikojnë dhe të nxjerrin në pah qëllimet e përbashkëta si pika të angazhimit. Organizatat e grave e llogarisin rrallë EDHRÇT ndër shqetësimet e tyre parësore. Ato merren më shumë me intolerancën, racizmin, diskriminimin, krimin e rrugës dhe krimin e organizuar dhe mungesën e qasjes në shërbimet sociale – disa nga të cilat mund të përbëjnë faktorë radikalizimi. Qeveritë, pra, duhet të përfitojnë nga një kuptim më i mirë i shqetësimeve të komuniteteve dhe duhet të përpiqen t'u përgjigjen më mirë këtyre shqetësimeve në vend që t'u përgjigjen thjesht objektivave të tyre për parandalimin e terrorizmit me anë të mbikëqyrjes.
28. Angazhimi me anëtarët e komunitetit, përfshi këtu gratë, nuk duhet të ketë si qëllim parësor mbledhjen e informacioneve. Parandalimi i terrorizmit do të përfitojë më shumë si një nën-produkt i angazhimit me gratë mbi shqetësimet e komuniteteve më të gjëra. Mbi bazën e një angazhimi të tillë dhe zhvillimit të marrëdhënieve të besimit, bashkëbiseduesit e komunitetit mund të jenë më të predispozuar të shkëmbejnë informacione me autoritetet publike, informacione që mund të jenë të dobishme në perspektivën e parandalimit të terrorizmit.

Fuqizimi i grave kundër EDHRÇT

29. Mbështetja e autoriteteve të shtetit dhe e organizatave joqeveritare është thelbësore për bërjen e grave autonome në kundërshtimin e diskurseve ekstremiste të dhunshme në gjirin e komuniteteve të tyre. Organizatat e grave dhe gratë avokate duhet të nxiten të marrin masa dhe të pajisen me kapacitete dhe aftësi teknike për t'ia përshtatur në mënyrë efikase mesazhin e tyre audiencave specifike, si në përmbajtje, në formë dhe përhapje. Gratë duhet të nxiten të zhvillojnë dhe të ndajnë burimet e tyre mbi historitë e fuqizimit të grave, gratë në histori dhe rolin prej modeli të grave, përfshi këtu nëpërmjet qendrave komunitare të informacionit dhe bazave të të dhënave të Internetit.
30. Është esenciale që gratë të pajisen me platforma dhe hapësira të sigurta, në nivelet ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore që u lejojnë të shprehin pikëpamjet e tyre, të ndajnë shqetësimet dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre në përballimin dhe trajtimin e EDHRÇT.
31. Shembuj nga gjithë rajoni i OSBE-së tregojnë se kontekstet e konflikteve të dhunshme mund të japin mësim të rëndësishme për angazhimin e grave kundër EDHRÇT. Duke çmontuar interpretimet patriarkale të rolit të gjinive, trajnimet mund t'u tregojnë pjesëmarrëseve se si pikëpamjet patriarkale ushqejnë dhunën seksiste gjatë konfliktit dhe se si ato mund të kundërshtohen në jetën e përditshme. Ky lloj iniciativash krijon parimin e një kuptimi më të mirë të gjinisë dhe mund t'u hapë rrugën iniciativave të reja të luftës kundër EDHRÇT në bashkësi të ndryshme.
32. Po ashtu, organizimi i veprimtarive dhe trajnimeve të destinuara për të lehtësuar qasjen e grave në edukimin kulturor, fetar dhe politik mund t'u lejonte atyre t'u kundërviheshin më mirë diskurseve ekstremiste të dhunshme. Këto diskurse mbështeten shpesh mbi interpretime të diskutueshme të fakteve dhe parimeve fetare që, nëse nuk kundërshtohen, mund të duken si e vetmja "e vërtetë". Këto veprimtari dhe trajnime duhet të organizohen rreth ideve të tolerancës dhe pluralizmit. Ato nuk duhet të konceptohen për ta imponuar një diskurs si e vetmja "e vërtetë", por më tepër t'u ofrojnë grave një treg idesh ku ato mund të formulojnë dhe të zgjedhin diskurset në të cilat besojnë. Duhet të favorizohet një atmosferë në të cilën mund të shprehen opinionet e ndryshme dhe pikëpamjet kritike dhe mund të nxirren në pah diskurse alternative që kundërshtojnë ideologjitë terroriste dhe ekstremiste të dhunshme duke nisur nga këndvështrime të ndryshme.
33. Rritja e sensibilizimit dhe kuptimit nga gratë të EDHRÇT është e nevojshme për t'i bërë ato të afta të ngrihen kundër tij. Megjithatë, përkufizimi i shenjave paraprijëse të këtij procesi është i vështirë në praktikë. Ashtu si nuk ka një rrugë të vetme për radikalizimin dhe nuk ka një profil terrorist unik, nuk mund të ketë as pika reference të lehta për t'u identifikuar, të sakta dhe përfundimtare. Radikalizimi është kryesisht një proces i brendshëm dhe treguesit potencialisht të vlefshëm nuk janë lehtësisht të kapshëm. Për më tepër, s'mund të ketë një provë të nevojshme dhe të mjaftueshme për radikalizimin e dhunshëm. Ndryshimet e dukshme të pamjes, si veshjet, nuk duhet të konsiderohen në vetvete si tregues të radikalizimit terrorist. Ndryshime të tjera të sjelljes si shikimi i videove të dhunshme ekstremiste apo përdorimi i retorikave që mbrojnë dhunën mund të bëhen shqetësim për autoritetet.
34. Përkufizimi i shenjave paraprijëse të radikalizimit terrorist është gjithashtu problematik nga pikëpamja e të drejtave të njeriut. E drejta për të pasur çfarëdo lloj ideologjie apo besimi – edhe nëse ato konsiderohen si radikale apo ekstreme – si dhe për t'i shprehur ato paqësisht, është një kërkesë demokratike e mbrojtur nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut dhe e sanksionuar në angazhimet e OSBE-së. Pasja e opinioneve radikale apo ekstreme s'mund të konsiderohet krim në vetvete nëse nuk shoqërohet me dhunë apo me një veprim tjetër të paligjshëm, siç përkufizohet juridikisht në përputhje me të drejtat

- ndërkombëtare të njeriut (për shembull, grupet ekstremiste që nuk përdorin, nxisin apo tolerojnë veprimtari kriminale dhe / ose dhunë). Çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të mbështetet në ligj, të jetë i justifikuar, i nevojshëm, proporcional dhe jo diskriminues.
35. Gjithashtu mund të konceptohen dhe sigurohen trajnime të veçanta për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave në sferën publike dhe rritjen e ndërveprimit të tyre me autoritetet publike. Edhe pse këto veprimtari mund të heqin një pengesë ndaj pjesëmarrjes së grave, duhet gjithashtu një ndryshim në perceptimin e grave dhe vullnetin e tyre për të bashkëpunuar me autoritetet. Ky ndryshim është thelbësor në mënyrë që gratë të mund të luajnë një rol aktiv duke qenë të parat që i përgjigjen EDHRÇT-it në bashkësinë e tyre.
 36. Fuqizimi i grave për të përhapur historitë e tyre në sferën publike mund t'i inkurajojë ato të sjellin dëshmi personale të cilave anëtarët e tjerë të komunitetit mund t'ju referohen më me lehtësi. Dëshmitë e viktimave të terrorizmit mundet, për shembull, të shërbejnë si kundër-diskurse efikase, duke e kundërshtuar dehumanizimin e viktimave në propagandën terroriste dhe duke këmbëngulur në karakterin kriminal të akteve të kryera nga terroristët. Dëshmia e një viktime mundet, në këtë kuptim, të ketë ndikim më të madh në publik se sa kundër-diskurset e prodhuara nga autoritetet.
 37. Po ashtu, përmasa gjinore duhet të përfshihet në përpjekjet që synojnë promovimin e dialogut ndër-kulturor dhe ndër-fetar. Kjo do ta lehtësonte pjesëmarrjen e grave në promovimin e tolerancës dhe të bashkëjetesës dhe në parandalimin e konflikteve përmes linjave etnike, kulturore dhe fetare, pra, do të ndihmonte gjithashtu në parandalimin dhe zbutjen e tensioneve që potencialisht mund të çojnë në terrorizëm të dhunshëm. Gratë mund të jenë në gjendje të angazhohen më me efikasitet dhe në mënyrë konstruktive dhe dialogu ndërmjet grave mund të jetë i mundshëm aty ku ai ka dështuar në forma të tjera.
 38. Kundër-diskurse efikase gjithashtu mund të jepen përmes dëshmimeve të ish-ekstremistëve të dhunshëm, kryesisht gra, që mund të ndihmojnë që të kuptohet se si janë ndërtuar diskurset ekstremiste të dhunshme dhe pse ato gjejnë vend në disa persona. Individët e çradikalizuar kanë përvoja konkrete që mund ta rrisin besueshmërinë e tyre dhe aftësinë e tyre për të prekur grupet e dobëta të prekshme nga rekrutimi ekstremist i dhunshëm dhe terrorist. Dëshmitë e tyre se pse ata kanë vendosur dhe/ose se si ia kanë dalë të largohen nga terrorizmi ose ekstremizmi i dhunshëm janë një mesazh i rëndësishëm kujtese për njerëzit në rrugën e radikalizimit të dhunshëm.
 39. Megjithatë, qeveritë duhet të marrin masa të mëtejshme për t'u lejuar grave të çradikalizuar të ndajnë historitë e tyre. Në radhë të parë, është thelbësore të sigurojnë një qasje më të mirë të grave ekstremiste të dhunshme në programet e rehabilitimit. Programet e drejtuara nga qeveritë dhe shoqëria civile duhet të ndjekin qasje specifike gjinore dhe grave që largohen nga mjedisi terrorist ose ekstremist i dhunshëm duhet t'u jepet mbështetja dhe mbrojtja e duhur në mënyrë që ato të mund të ri-integrohen në shoqëri pa u kërcënuar nga reпреzaljet apo recidivizmi për shkak të mungesës së alternativave.
 40. Diskurset terroriste dhe ekstremiste të dhunshme janë të ndryshme, të kudondodhura dhe në zhvillim konstant. Po ashtu kundër-diskurset duhet të jenë të fuqishme, dinamike dhe të shpërndahen me metoda krijuese në mënyrë që të kenë rëndësi dhe ndikim më të madh. Është e rëndësishme që organizatat e grave të angazhuara në luftën kundër EDHRÇT të jenë të pajisura dhe të trajnuara më mirë në mënyrë që ta shpërndajnë në mënyrë efikase mesazhin e tyre, për të arritur një publik më të gjerë dhe/ose audiencë shënjestër specifike dhe për të zhvilluar rrugë të reja për të mbërritur tek ata. Kundër-diskurset duhet të shprehen në gjuhën e përshtatshme dhe duke përdorur pamjet e duhura për audiencat e synuara, si dhe të transmetohen përmes kanaleve tradicionale dhe/ose mediave sociale, blogjeve, filmave vizatimorë apo animacioneve, sipas rastit.

Rekomandime

Në të dy tryezat e rrumbullakëta, pjesëmarrësit formuluan rekomandime për veprime që duhen ndërmarrë nga qeveritë dhe shoqëria civile në përputhje me të drejtat e njeriut, duke sugjeruar mënyrën e përmirësimit të masave për parandalimin e radikalizimit terrorist të grave dhe lehtësimin e angazhimeve të grave si forca në luftën ndaj EDHRÇT. U identifikuan gjithashtu fokusi i duhur dhe ndjekja e veprimtarive të mundshme nga strukturat ekzekutive të OSBE-së, në kuadrin e mandatit të tyre përkatës.

Kjo listë rekomandimesh nuk është shteruese dhe përfaqëson opinionet e shprehura nga pjesëmarrës të ndryshëm gjatë dy tryezave të rrumbullakëta. Rekomandimet nuk janë të mbështetura në konsensus dhe nuk shprehim qëndrimin zyrtar të OSBE-së.

Rekomandimet për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së

- A1. Të riafirmojnë se mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut është në qendër të të gjitha politikave efikase antiterroriste.
- A2. Të promovojnë lirinë e shprehjes dhe të mos ndëshkojnë dhe të mos shtypin shprehjen paqësore të opinioneve radikale jo të dhunshme ose ekstremiste.
- A3. Të mos përdorin masa antiterroriste diskriminuese si profilizimi paraprak i bazuar mbi racën, origjinën etnike, fenë dhe/ose gjininë.
- A4. Të promovojnë barazinë gjinore në të drejtën e tyre dhe të shmangen nga nënvleftësimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia i barazisë e gjinive dhe të drejtave të grave në kontekstin e luftës kundër terrorizmit.
- A5. Të shmangin instrumentalizimin e angazhimit me gratë dhe organizatat e grave për qëllime politike ose të mbledhjes së informacioneve. Parandalimi i terrorizmit do të përfitojë më shumë si një nën-produkt i angazhimit transparent me gratë mbi çështje më të gjera të sigurisë së komunitetit.
- A6. Të rrisin sensibilizimin ndaj radikalizimit terrorist të grave dhe përfshirjes së grave në terrorizëm, duke nxitur sensibilizimin e prindërve, punonjësve socialë, oficerëve të policisë së vijës së frontit, gazetarëve dhe gjykatësve për të larguar stereotipat dhe idetë e gabuara.
- A7. Të lejojnë dhe mbështesin kërkimin mbi radikalizimin terrorist të grave, veçanërisht për faktorët favorizues së tij, dhe mbi rolin logjistik dhe ideologjik të grave në grupet terroriste.
- A8. Të rrisin ndërveprimin dhe shkëmbimin e informacioneve me hulumtuesit mbi radikalizimin terrorist të grave për të lehtësuar informacionin e politikë-bërësve përmes rezultateve të hulumtimeve.
- A9. Të përfshijnë gratë në mënyrë efikase dhe t'i bëjnë ato të marrin pjesë në të gjitha fazat e zhvillimit, vënies në jetë dhe vlerësimit të strategjive, politikave dhe masave të luftës kundër terrorizmit dhe kundër radikalizimit.
- A10. Të mbikëqyrin dhe vlerësojnë rregullisht, përfshi këtu mbi bazën e kriterëve specifike të gjinisë, efikasitetin, efektet negative dhe pozitive të politikave dhe praktikave antiterroriste dhe kundër radikalizimit.
- A11. Të përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet organizmave qeveritare dhe të krijohen forume për një bashkëpunim ndër-agjenci për forcimin e ndërgjegjësimit mbi gjininë dhe sigurinë midis të gjithë të interesuarve.

- A12. Të rrisin praninë e grave midis profesionistëve të luftës kundër terrorizmit, vendimmarrësve në agjencitë e zbatimit të ligjit dhe ushtarake, në të gjitha nivelet dhe funksionet dhe të hiqen pengesat e marrjes së tyre në punë dhe avancimit në karrierë.
- A13. Të krijohen trajnime gjinore të detyrueshme për të gjithë – përfshi këtu ushtarakët – për personelin e sektorëve publikë dhe privatë për të kryer kontrole sigurie dhe kontrole trupore, veçanërisht ata që punojnë në aeroporte, burgje ose pika të tjera kontrolli.
- A14. Të nxirren përvoja nga përfshirja e grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe në konsolidimin e paqes për të rritur pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e procesit të vendimmarrjes në parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit.
- A15. Lidhja e një partneriteti të mirëfilltë me organizatat bazë të grave, duke nxjerrë në pah idenë e bashkëpunimit drejt qëllimeve të përbashkëta, në përpjekje për të trajtuar shqetësimet parësore të komuniteteve (p.sh., intolerancën, racizmin, diskriminimin, krimin e rrugës, krimin e organizuar dhe mungesën e qasjes në shërbimet sociale) dhe duke qenë transparent në lidhje me shqetësimet për parandalimin e terrorizmit.
- A16. Të identifikohen gratë aktiviste dhe organizatat kryesore, me aftësitë dhe nevojat e tyre, në mënyrë që të diversifikohet partneriteti për përfshirjen dhe arrijten e grupeve të ndryshme.
- A17. T'i jepet përparësi angazhimit me organizatat e vogla bazë të grave më fort se sa me udhëheqësit e vetëshpallur të komuniteteve ose vetëm me organizata të mëdha dhe tëkonsoliduara.
- A18. Të trajtohen çështjet e gjuhës dhe etiketimit për të shmangur konotacionet negative. Për shembull, të flitet për "mbrojtje" të komuniteteve nga terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm më mirë se për "parandalim" të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; të jepen financime nën etiketa të tjera, të ndryshme nga lufta kundër terrorizmit.
- A19. Të merret në konsideratë rishikimi dhe modifikimi i ligjeve dhe rregulloreve kundër financimit të terrorizmit për të lehtësuar qasjen në financim të organizatave të vogla dhe të pa konsoliduara të grave dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- A20. Të mbështeten iniciativat e shoqërisë civile për edukimin e grave për historinë e tyre kulturore, fetare dhe politike në mënyrë që t'u lejohet të përpunojnë dhe diskutojnë për mesazhet e ndryshme normative që sfidojnë diskursin ekstremist.
- A21. Të organizohen ose mbështeten organizatat e trajnimit për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave në sferën publike dhe të rritet angazhimi me to. Është thelbësore që gratë të mund të luajnë një rol aktiv si të interesuarat e para kundër radikalizimit terrorist në komunitetin e tyre.
- A22. Të sigurohet një qasje më e mirë e grave në programet e ndjeshme gjinore të çangazhimit dhe rehabilitimit duke u dhënë atyre mbrojtje dhe mbështetje të përshtatshme.
- A23. Të mbështetet furnizimi i platformave dhe i hapësirave të sigurta për gratë për të ndarë burimet, përvojat dhe shqetësimet në përballjen me radikalizimin e dhunshëm, përfshi aftësitë dhe mjetet për t'u përgjigjur në mënyrë më efektive.

Rekomandime për strukturat ekzekutive të OSBE-së

- B1. Angazhimi më i afërt dhe i rregullt me shtetet pjesëmarrëse dhe shoqërinë civile për çështjen e radikalizimit terrorist dhe rolin e grave në luftën kundër EDHRÇT.
- B2. Të sigurojnë një forum për të lehtësuar diskutimin ndërmjet autoriteteve shtetërore, shoqërisë civile dhe hulumtuesve mbi çështjen e radikalizimit terrorist të grave, mënyrat për ta parandaluar dhe luftuar atë, si dhe rolin e grave në luftën kundër EDHRÇT.

- B3. Të lehtësojnë krijimin e rrjeteve dhe shkëmbimet rajonale ndërmjet grave dhe organizatave të grave të angazhuara në luftën kundër EDHRÇT.
- B4. Të eksplorojnë rolin e policisë komunitare në luftën kundër EDHRÇT dhe aspektet gjinore në këtë kontekst.
- B5. Të ndihmojnë shtetet pjesëmarrëse, sipas kërkesës së tyre, që të integrojnë gjininë në politikat dhe praktikën e tyre kundër terrorizmit, duke përfshirë realizimin e një vlerësimi të ndikimit të barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut, si dhe të mbështesin iniciativat e këshilluese dhe të partneritetit.

Rekomandime për shoqërinë civile

- C1. Të monitorojë vazhdimisht aktet e ekstremizmit të dhunshëm të kryera nga gratë dhe të hulumtojë mëtej çështjen e radikalizimit terrorist të grave, veçanërisht faktorët favorizues për këtë dhe rolin e grave në grupet terroriste.
- C2. Të shtojë punën statistikore dhe monitoruese dhe të angazhohet me qeveritë në një dialog të hapur dhe të mbështetur në fakte mbi efikasitetin dhe ndikimet e masave antiterroriste mbi gratë.
- C3. Të monitorojë vazhdimisht dhe të mbrojë praninë e grave midis profesionistëve të kundër-terrorizmit dhe të promovojë pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fazat e zhvillimit, vënies në jetë dhe vlerësimit të strategjive, politikave dhe masave kundër terrorizmit dhe kundër radikalizimit.
- C4. Të rrisë sensibilizimin ndaj radikalizimit terrorist të grave dhe përfshirjes së grave në terrorizëm, të sensibilizojë prindërit, punonjësit socialë, policët e vijës së parë të frontit, gazetarët dhe gjykatësit për të shmangur stereotipat dhe konceptet e gabuara.
- C5. Të organizojë veprimtari dhe trajnime për të lehtësuar qasjen e grave në edukimin kulturor, fetar dhe politik në mënyrë që ato të aftësohen për të përpunuar dhe diskutuar mbi mesazhet e ndryshme normative duke sfiduar diskurset ekstremiste.
- C6. Të organizojë trajnime për të forcuar besimin e grave për të ndërhyrë në sferën publike dhe për t'i nxitur të luajnë një rol aktiv, duke qenë të parat që i përgjigjen radikalizimit terrorist në komunitetet e tyre.
- C7. Të sigurohet një qasje më e mirë e grave në programet gjinore të çangazhimit dhe rehabilitimit duke u dhënë atyre një mbrojtje dhe një mbështetje e përshtatshme.
- C8. T'u sigurohen grave platforma dhe hapësira të sigurta për ndarjen e burimeve, përvojave dhe shqetësimeve përballë radikalizimit të dhunshëm, përfshi këtu kompetencat dhe mjetet për t'iu përgjigjur atij në mënyrë më efektive.
- C9. Të merret përvojë nga iniciativat e shoqërisë civile në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe në konsolidimin e paqes për të zhvilluar më shumë rolin e grave dhe veprimtarinë e zhvilluara nga gratë për të luftuar kundër EDHRÇT.

Shtojca 1: Mandati dhe zotimet e OSBE-së

Organizimi i dy tryezave të rrumbullakëta të ekspertëve u mbështet në mënyrë specifike për angazhimet në vijim të OSBE-së:

- **Deklarata Ministrore MC.DOC/3/07 mbi Mbështetjen e Strategjisë antiterroriste globale të Kombeve të Bashkuara** që nënvizon që: "OSBE-ja do t'i vazhdojë veprimtaritë e saj kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm, intolerancë dhe diskriminim. Intoleranca dhe diskriminimi duhet të trajtohen dhe kihen parasysh nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe strukturat ekzekutive të OSBE-së brenda mandateve të tyre përkatëse".
- **Vendimi i Këshillit Ministror 10/08 mbi promovimin e mëtejshëm të veprimit të OSBE-së në luftën kundër terrorizmit**, që "u bën thirrje shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së t'i përdorin strukturat ekzekutive në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm në vendet e tyre përkatëse. Për këtë qëllim, shtetet pjesëmarrëse inkurajohen të vazhdojnë të shkëmbejnë ide dhe praktikat më të mira mbi strategjitë dhe masat e tyre për të luftuar ekstremizmin dhe radikalizimin që çon në terrorizëm, si dhe të forcojnë bashkëpunimin e tyre me mediat, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile."
- **Vendimi i Këshillit Ministror 5/07 mbi Partneritetin publik-privat në luftën kundër terrorizmit** që "e ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm dhe institucionet e OSBE-së të vazhdojnë të promovojnë përfshirjen e sektorit privat (shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit) në veprimtaritë e tyre kundër terrorizmit, ku duhet dhe është e përshtatshme."
- **Vendimi i Këshillit Ministror 14/05 mbi gratë në parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave dhe rehabilitimin pas konflikteve** që u bën thirrje "shteteve pjesëmarrëse dhe strukturave të OSBE-së, sipas rastit, të mbështesin dhe nxisin programet trajnuese dhe edukuese që fokusohen tek gratë dhe vajzat, si dhe projektet që kanë si qëllim pjesëmarrjen e grave në krijimin e paqes së qëndrueshme; të fuqizojnë organizatat e grave; të mbështesin nismat e grave për paqe përmes medias dhe workshopeve mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore; dhe të rrisin sensibilizimin mes grave në lidhje me rëndësinë e përfshirjes së tyre në proceset politike." Ai u bën gjithashtu thirrje "shteteve pjesëmarrëse dhe strukturave të OSBE-së, sipas rastit, të zhvillojnë politika specifike për nxitjen e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave dhe organizatave të grave në parandalimin e konflikteve, zgjidhjen e konflikteve dhe rehabilitimin pas konfliktit, si dhe të nxisin dhe mbështesin ndarjen e përvojave dhe praktikave më të mira dhe për më tepër të angazhohen me nismat e grave për paqe."
- **Vendimi i Këshillit Ministror 14/04 mbi Planin e veprimit të OSBE-së të vitit 2004 mbi promovimin e barazisë gjinore** që "e ngarkon Njësinë e Veprimit kundër terrorizmit të marrë masa, kur i kërkohet, mbi çështjen e shfrytëzimit të grave nga terroristët për t'u shërbyer qëllimeve të tyre dhe për përhapjen e ideologjive ekstremiste."

Shtojca 2: Axhenda e tryezës së rrumbullakët të përbashkët të ekspertëve të sekretariatit OSBE-ODIHR mbi “Parandalimin e radikalizimit terrorist të grave”, 12 Dhjetor 2011, Vjenë

08:30-09:00 Regjistrimi

09:00-09:30 Fjalët e mirëseardhjes

- Z. Raphael Perl, Kryetar, Njësia e OSBE-së e veprimit kundër terrorizmit
- Znj Snježana Bokulić, Kryetare, Departamenti i të Drejtave të Njeriut, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
- Znj. Hanna Sands, Oficer gjinor, Seksioni Gjinator i Sekretariatit të OSBE-së

09:30-10:30 Prezantimi hyrës kryesor

Fjalimi hyrës kryesor do të diskutojë nevojën për të integruar gratë në përpjekjet kundër terrorizmit dhe për të përpunuar masa në përputhje me të drejtat e njeriut për të luftuar me efikasitet kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. Prezantimi do të ndiqet nga një diskutim me reagime, komente dhe pyetje nga salla.

- Ms Jayne Huckerby, Drejtor kërkimesh, CHRGI dhe Klinika globale e drejtësisë, NYU School of Law, ShBA.

Moderator: Dr Miriam Estrada-Castillo, Oficer ligjor dhe pikë kontakti për çështje gjinore, Drejtorja e Komitetit Ekzekutiv kundër terrorizmit e Kombeve të Bashkuara (UNCTED) - TBC

10:30-11:00 Pushimi i kafesë

11:00-13:00 Paneli dhe diskutimi i mëngjesit: Të kuptuarit e radikalizimit terrorist të grave

Ku sesion synon të krijojë një kuptim më të mirë të specifikave dhe dinamikave të mundshme që përfshihen në radikalizimin terrorist të grave. Pjesëmarrësit do të diskutojnë për pikat e përbashkëta dhe dallimet në radikalizimin e grave/rekrutimin për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin siç merr formë në ideologjitë e ndryshme. Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë çështje të tilla si faktorët që i bëjnë gratë të dobëta ndaj radikalizimit, mesazhet e formuluar dhe të orientuara drejt grave dhe mediat e përdorura për të arritur gratë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet diskutimit të shkëlqes së të drejtave themelore të grave dhe ndikimit negativ të masave antiterroriste mbi gratë si faktorë të mundshëm të favorshëm për radikalizimin e dhunshëm.

- Dr Carrie Hamilton, Lektor në histori, Universiteti i Roehampton, Mbretëria e Bashkuar
- Znj. Lisa Bjurwald, Gazetare investigative, Redaktore në Medievarlden, Suedi
- Dr Anne Speckhard, profesore e asociuar në psikiatri, në shkollën mjekësore të Universitetit Georgetown, ShBA

Moderator: Dr Mia Bloom, profesor i asociuar, Pennsylvania State University, ShBA

Raportues: Z. Richard L. Prosen, Oficer i Çështjeve të Jashtme, Departamenti i Shtetit të ShBA

13:00-14:00 Pushimi i drekës

14:00-16:00 Paneli i pasdites: Parandalimi i radikalizimit terrorist të grave

Duke u mbështetur në të kuptuarit më të nuancuar të arritur në mëngjes mbi radikalizimin terrorist të grave, ky seksion ka si objektiv të reflektojë nëse dhe si masat ekzistuese për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çon në terrorizëm duhet të korrigojen ose përshtatur për të fituar efikasitet në parandalimin e radikalizimit terrorist të grave në kontekste të ndryshme. Veçanërisht, pjesëmarrësit do të shqyrtojnë rrugët në të cilat përpjekjet e tanishme mund të bëheshin më të ndjeshme ndaj gjinisë dhe në përputhje me të drejtat e njeriut. Një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet njëkohësisht politikave dhe masave të marra nga autoritetet shtetërore dhe (nevojës për) nismat dhe veprimtaritë e shoqërisë civile. Panelistët dhe pjesëmarrësit do të ftohen të formulojnë rekomandime që lejojnë të identifikohen veprime konkrete dhe praktike nga qeveritë dhe organizatat e shoqërisë civile.

- Dr Nazila Ghanea, Lektor për Ligjin Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut, Universiteti i Oksfordit, Mbretëria e Bashkuar
- Dr Heike Radvan, Shef i Departamentit për Parandalimin e Ekstremizmit të Djathtë Gjinnor, Fondacioni Amadeu Antonio Gjermani

Moderator: Dr Karla J. Cunningham, Shkencëtar Politik, Korporata RAND

Raportues: Z. Ivan Calabuig-Williams, Këshilltar, Instituti i Kombeve të Bashkuara për Kërkime të Krimin Ndër-rajonal dhe Drejtësi (UNICRI)

16:00-16:30 Pushimi i kafesë

16:30-17:30 Përmbledhje e rezultateve dhe rekomandimeve

Raportuesit përmbledhin në mënyrë të përgjithshme çështjet kryesore të shqyrtuara dhe konkluzionet e paneleve të tyre përkatëse. Një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet rekomandimeve të formuluar nga pjesëmarrësit për qeveritë, shoqërinë civile dhe OSBE-në. Raportet e tyre do të ndiqen nga një diskutim i pjesëmarrësve për të bërë komente dhe sugjerime plotësuese.

- Z. Richard L. Prosen, Raportues nga paneli i mëngjesit
- Z. Ivan Calabuig-Williams, Raportues nga paneli i pasdites
- Tryezë e rrumbullakët

Moderatorë: Sekretariati i OSBE - ODIHR

17:30-18:00 Fjalët mbyllëse

- Z. Raphael Perl, Kryetar, Njësia e OSBE-së veprimi kundër terrorizmit
- Znj Snježana Bokulić, Kryetare, Departamenti i të Drejtave të Njeriut, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejta të njeriut
- Znj Hanna Sands, Oficer gjinnor, Sekretariati i OSBE-së seksioni gjinnor

Shtojca 3: Axhenda e tryezës së rrumbullakët të përbashkët të ekspertëve të sekretariatit të OSBE-ODIHR mbi “Rolin dhe fuqizimin e grave në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit të grave që çon në terrorizëm”, 12-13 Mars 2012, Vjenë

09:00-09:30 Fjalët e mirëseardhjes

- Mr Patrick O'Reilly, kryetar i sesionit, Komiteti i sigurisë dhe i SBM, Misioni i përhershëm i Irlandës në OSBE
- Znj. Assia Ivantcheva, kryetare *par interim*, Departamenti i të drejtave të njeriut të zyrës së OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR)
- Z. Thomas Wuchte, Kryetar për çështjet anti-terrorizëm, Departamenti i kërcënimeve transnacionale, Njësia e veprimit kundër terrorizmit (TNT/ATU), Sekretariati i OSBE-së
- Znj. Ambasadore Miroslava Beham, Këshilltare kryesore gjinore, seksioni gjinor, zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së

09:30-10:30 Prezantimi kryesor hyrës: Të kuptuarit e roleve të grave për ta luftuar EDHRÇTnë mënyrë efikase

Diskutimi kryesor hyrës do të lejojë të identifikohen konceptet kyçe dhe do të trajtojë se si mund të kuptohen “roli i grave” dhe “fuqizimi” në kontekstin e luftës efikase kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm (EDHRÇT). Paraqitja dhe diskutimi vijues do të nxjerrin në pah veçantitë e angazhimit të grave në luftën kundër EDHRÇT dhe do të diskutohen paralele të mundshme me pjesëmarrjen e grave në luftën kundër formave të tjera të dhunës. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet identifikimit të konsideratave në lidhje me të drejtat e njeriut që mund të lindin në këtë kontekst.

- Folësi kryesor: Znj. Khizra Dhindsa, Inspektor Detektiv, Shoqata e oficerëve shefa policie, Mbretëria e Bashkuar

Prezantues: Znj. Maj Britt Theorin, Kryetare, Operation 1325, Suedi

10:30-11:00 Pushimi i kafesë

11:00-13:00 Paneli i diskutimeve: Gratë si forca kundër radikalizimit: praktikat e mira dhe mësimet e fituara

Paneli do të diskutojë atë ç'ka njihet nga angazhimi i grave në luftën kundër EDHRÇT, do të paraqesë një panoramë të përgjithshme të hulumtimeve të disponueshme në këtë fushë dhe do të japë shembuj të grave si forca emancipuese në luftën efikase kundër EDHRÇT. Diskutimi synon të identifikojë praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra nga kontekste të ndryshme, duke u ofruar pjesëmarrësve një kuptim më të mirë të asaj që i motivon gratë të ngrihen kundër EDHRÇT. Përveç kësaj, do të trajtohen shqetësimet e mundshme nga perspektiva gjinore dhe e të drejtave të njeriut, si dhe pengesat që ndeshin gratë në luftën kundër EDHRÇT. Çështjet që do të trajtohen përshtjell: potencialin e veçantë të grave për të luftuar EDHRÇT (gratë si politikë-bërëse, aktiviste, mbrojtëse të të drejtave të njeriut, edukatore, avokate, ndërmjetësuese në konflikte); shembuj të praktikave të mira dhe të mësimet e nxjerra: (kur, ku dhe si gratë e kanë luajtur një rol në luftën kundër EDHRÇT); cilat janë kushtet e nevojshme që nisma të tilla të jenë efikase?

- Znj. Elaine Hargrove, Drejtore Programi, Motrat kundër ekstremizmit të dhunshëm (SAVE) / Gra pa kufij
- Znj. Jane Mosbacher, Këshilltare kundër terrorizmit, zyra e koordinorit të luftës kundërterrorizmit, Departamenti i shtetit, ShBA
- Znj. Catherine Cooke, Rrjeti i informimit të grave Foyle, Mbretëria e Bashkuar
- Dr Jayne Huckerby, Konsulent, Qendra për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë globale, NYU School of Law, ShBA

Moderator: Znj Anne-Marie Faradji, Oficere e barazisë gjinore, Këshilli i Evropës

Raportues: Z. Timothy Jones, Këshilltar kryesor i koordinorit të Bashkimit Evropian për luftën kundër terrorizmit

13:00-14:00 Pushimi i drekës

14:00-17:00 Sesionet e grupeve të punës: Emancipimi i grave për të luftuar kundër EDHRÇT

Duke u mbështetur në diskutimet e panelit të mëngjesit, sesionet e grupit të punës do të përpiqen të identifikojnë masat e duhura gjinore dhe të të drejtave të njeriut për të forcuar rolin e grave dhe për të lehtësuar fuqizimin e tyre për të luftuar me efikasitet kundër EDHRÇT. Çdo grup pune do të formulojë rekomandime për veprime konkrete, praktike dhe në përputhje me të drejtat e njeriut nga qeveritë, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare për të ecur përpara, duke u mbështetur mbi kontributet e perspektivave, përvojave dhe praktikave të ndryshme.

Grupi i punës 1 – Mbërritja tek audiencat e synuara për të luftuar kundër EDHRÇT

Pyetjet që do trajtohen përfshijnë: Si të fuqizohen gratë për t'u lejuar atyre të luajnë një rol parandalues dhe të arrijnë publikun e synuar? Si të rritet ndërgjegjësimi dhe kuptimi i grave për shenjat e para të radikalizimit terrorist për t'i trajtuar ato në mënyrë efikase? Si mundën gratë të arrijnë publikun e synuar? Në cilin publik të synuar mund të ndikojnë më mirë gratë?

Prezantues: Znj. Elin Wedebrand, EXIT, Suedi

Moderator: Z. Ivan Calabuig-Williams, Këshilltar i lartë, Instituti i Kombeve të Bashkuara për krimin ndër-rajonal dhe hulumtime në drejtësi (UNICRI)

Raportues: Znj. Shaista Gohir, Aktiviste e të drejtave të njeriut, Mbretëria e Bashkuar

Grupi i punës 2 – Modelimi i mesazhit normativ për të luftuar kundër EDHRÇT

Çështjet që do trajtohen përfshijnë: Si të fuqizohen gratë për të zhvilluar kundër-diskurse ndaj EDHRÇT? Cilat janë veçoritë e kontributit të grave në zhvillimin e kundër-diskurseve—përmbajtja, paketimi dhe shpërndarja e tyre? Si mund të komunikojnë në mënyrë specifike gratë mbi tema të tilla si toleranca, paqja, dialogu, të drejtat e njeriut dhe jo-dhuna? Si mund të ndërveprojnë në mënyrë efikase gratë me aktorët e tjerë në këtë proces, përfshi këtu qeveritë, mediat dhe organizatat fetare?

Prezantues: Znj. Ana Velasco Vidal-Abarca, *Asociación Víctimas del Terrorismo*, Spanjë

Moderator: Znj. Vidhya Ramalingam, Koordinator, Gratë myslimane evropiane të nismave ndikuese, Instituti për dialog strategjik, Mbretëria e Bashkuar

Raportues: Dr. Vlasta Jalušič, Hulumtuese, Instituti për paqe, Slloveni

Grupi i punës 3 – Transmetimi përmes veprimit i mesazhit kundër EDHRÇT

Çështjet që do të trajtohen: Si të fuqizohen gratë për të ndërmarrë nisma kundër EDHRÇT? Cilat janë mjetet praktike dhe aftësitë e nevojshme për të forcuar rolin e grave në

kundërvënien me sukses ndaj EDHRÇT? Si mundën gratë në mënyrë specifike të marrin masa për të ndikuar dhe fuqizuar audiencat e synuara? Cilat janë praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra dhe të transmetueshme nga roli i grave në luftën kundër formave të tjera të dhunës?

Prezantuesi: Znj. Tahmina Saleem, Menaxher ekzekutiv, Inspire, Mbretëria e Bashkuar

Moderator: Znj. Miriam Estrada-Castillo, Oficer ligjor dhe pika fokale gjinore, Drejtorja ekzekutive e Komitetit të Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit (UNCTED)

Raportues: Znj. Julia Pfänder, Manaxher projekti dhe lehtësues, Cultures Interactive, Gjermani

Dita 2

09:00-10:30 Sesioni përmbyllës: rruga për t'u ndjekur

Raportuesit do të përmbledhin, analizojnë, do të bëjnë konkluzionet e diskutimeve dhe do të japin rekomandimet nga paneli dhe grupet e punës si dhe do të sugjerojnë rrugët që duhen ndjekur në forcimin dhe lehtësimin e angazhimit të grave si forca që i kundërvihen EDHRÇT. Sesioni ofron gjithashtu një tribunë për të gjithë pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët për të reaguar ndaj rekomandimeve të formuluar nga çdo grup pune dhe për të ngritur çështje dhe shqetësime.

Moderator: Znj. Jane Mosbacher, Këshilltare kundër terrorizmit, Zyra e koordinorit të kundër terrorizmit, Departamenti i shtetit, ShBA

- Raportues nga diskutimet e panelit: Z. Timothy Jones, Këshilltar kryesor i koordinorit të Bashkimit Evropian për luftën kundër terrorizmit
- Raportues nga grupi i punës 1: Znj. Shaista Gohir, Aktiviste e të drejtave të njeriut, Mbretëria e Bashkuar


10:30-11:00 Pushim kafeje

11:00-12:30 Sesioni i konkluzioneve: rrugët për t'u ndjekur

- Raportues nga grupi i punës 2: Dr. Vlasta Jalušič, Hulumtuese, Instituti për paqe, Slloveni
- Raportues nga grupi i punës 3: Znj. Julia Pfänder, Manaxher projekti dhe lehtësues, Cultures Interactive, Gjermani

12:30-13:00 Fjalët mbyllëse

- Z. Thomas Wuchte, Kryetar për çështjet anti-terrorizëm, Departamenti i kërcënimeve transnacionale, Njësia e veprimit kundër terrorizmit (TNT/ATU), Sekretariati i OSBE-së
- Znj. Ambasadore Miroslava Beham, Këshilltare kryesore gjinore, seksioni gjinor, zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së
- Znj. Assia Ivantcheva, kryetare *par interim*, Departamenti i të drejtave të njeriut të zyrës së OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR)
- Z. Patrick O'Reilly, kryetar i sesionit, Komiteti i sigurisë dhe CSBM, Misioni i përhershëm i Irlandës në OSBE



Organization for Security and
Co-operation in Europe



ODIHR